



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 24/2010

Prishtinë, 15. 06. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Zef Morina, Fatmir Rexhepi, Mursel Halilij, Adem Grabovci dhe Sala Berisha – Shala.

Munguan: Kaqusha Jashari, Muferra Sinik dhe Qamile Morina.

Pjesëmarrës të tjerë: Ruzhdi Shehu dhe Lebibe Haliti – MTI, Sanije Berisha – OSBE, Haxhi Gashi – USAID, Besnik Ramadanaj – KDI dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi mbështetës: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të 08. 06. 2010;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181;
4. Shqyrtimi implementimit të Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian;
5. Të ndryshme.

***Kryetarja** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 08. 06. 2010

Procesverbali i mbledhjes së 08. 06. 2010 u miratua pa vërejtje

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181

Kryetarja – E hapi debatin për çështjet e hapura për Raportin e Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe për Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181. Ia dha fjalën Ruzhdi Shehut, kryeinspektor i MTI-së për t'i paraqitur propozimet e tij për nenet 37 dhe 38.

Neni 37

Ruzhdi Shehu - kryeinspektor i MTI-së – Pas konsultimit me Departamentin Ligjor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal kemi konstatuar se dhënia e lejeve për ushtrimin e veprimtarisë mbetet kompetencë e Komunës, ndërsa statusi i inspektorëve të tregut duhet të jetë në përputhje me praktikën më të mira të vendeve në rajon, të vendeve evropiane dhe të akteve të BE-së. Qëndroj pranë propozimamendamentit, që është deklaruar më 08. 06. 2010, sepse nuk paraqet kolizion të këtij ligji dhe të Ligjit për vetëqeverisje lokale, përkatësisht të nenit 17.

Propozimamendamenti u përkrah nga Komisioni.

Neni 38

Ruzhdi Shehu - kryeinspektor i MTI-së – Edhe pse në mbledhjen e kaluar kam kërkuar të ndryshohet neni 38, tërhiqem nga propozimi. Të mbetet në tërësi neni 38, siç është në Projektligj.

Haxhi Gashi - USAID – Propozoi që neni 38 të mos ndryshohet, sepse është shumë i qartë dhe i thjeshtë. Në të kërkohet të shfuqizohen Ligji dhe aktet e tjera, që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Propozimi u përkrah nga Komisioni, d.m.th. të mbetet neni 38 i këtij Projektligji.

Ruzhdi Shehu - kryeinspektor i MTI-së – Kërkoi nga Komisioni që në Kapitulli II, te parimet e punës së Inspektoratit të Tregut, pas nenit 5 të shtohet neni i ri 6, sepse duke u bazuar në Rregulloren e BE-së 765/2008 duhet të ceket metoda e vlerësimit të rrezikut, që e sjellin tregu dhe produktet e tregut për jetën, për shëndetin dhe për sigurimin e qytetarëve.

Adem Grabovci – U pajtua në parim, por kërkoi formulim më të qartë të propozimamendamentit.

Haxhi Gashi - USAID – E paraqiti formulimin për këtë nen:

Neni 6

Inspektorati në veprimtarinë e tij duhet të bazohet në metodën e vlerësimit të rrezikut, që sjellin tregu dhe produktet e tregut për jetën, për shëndetin dhe për sigurinë e qytetarëve.

Propozimamendamenti u përkrah nga Komisioni.

Murselj Halilji – I paraqiti vërejtjet e tij për disa nene: në paragrafin 7 të nenit 7 fjalët **marrëdhënie e punës**, të zëvendësohen me fjalët **kontrata e punës**; paragrafi 4 i nenit 7, që ka të bëjë me vulat, të zhvendoset te neni 9; nuk është përcaktuar afati i mbikëqyrjes inspektuese te paragrafi 6 i nenit 11. Po ashtu theksoi se ka paqartësi te paragrafi 5 i nenit 15 dhe te paragrafi 2 i nenit 16. Shtoi se paragrafi 2 i nenit 17 është konfuz në tërësi. Në fund theksoi se duhet të përcaktohen saktësisht **të drejtat e autorit** në paragrafin 1.10 të nenit 6.

Ethem Çeku - Theksoi se duhet të merren për bazë propozimet e z. Halilji.

Ruzhdi Shehu - kryeinspektor i MTI-së – Propozimi i deputetit për paragrafin 1.10 të nenit 6 për të drejtat e autorit është i pabazuar, sepse kjo çështje rregullohet me ligje të tjera të veçanta.

Adem Grabovci - E përkrahu propozimamendamentin e deputetit Halilji për paragrafin 2 të nenit 17.

Haxhi Gashi - USAID – E paraqiti riformulimin e paragrafit 2 të neni 17:

2. *Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet plotësisht në rastet kur produkti asgjësohet dhe shpenzimet për asgjësim i bartë subjekti ekonomik.*

Propozimamendamenti u përkrah nga Komisioni.

Pas debatit Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

I. Miratohet Raporti i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe për Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181.

II. Amendamentet e miratuara i bashkëngjiten këtij procesverballi.

5. Shqyrtimi i implementimit të Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian

Kryetarja – Kërkoj nga Komisioni të formohet grupi i punës, të hartohet Raporti për Planin e veprimit dhe t'i dorëzohet brenda një javë Komisionit për Integritet Evropian.

Ethem Çeku – I propozoj për grupin e punës Fatmir Rexhepin dhe Adem Grabovcin.

Fatmir Rexhepi – Nuk mund të jem në këtë grup pune, sepse jam kryetar i Komisionit për Peticione dhe për të Drejtat e Njeriut, si dhe anëtar i Komisionit për Integritet.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

- I. *Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian në këtë përbërje: Adem Grabovci kryesues, Myzejene Selmani, Ethem Çeku, Zef Morina dhe Mufera Sinik.*
- II. *Në takimin e Komisionit për Integritet Evropian në Gjakovë, më 28 dhe 29 qershor 2010, Komisionin do ta përfaqësojnë Adem Grabovci dhe Zef Morina.*

6. Të ndryshme

a) Raporti vjetor i ART-së

Kryetarja – Kërkoj të hartohen rekomandimet për Raportin vjetor të ART-së nga grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për telekomunikacion nr. 2002/7.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Autorizohet kryesuesi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për telekomunikacion nr. 2002/7, Zef Morina, t'i hartojë rekomandimet për Raportin vjetor të ART-së.

b) Projektligji për miniera dhe minerale nr. 03/L-163

Kryetarja – E njoftoi Komisionin se gjatë shqyrtimit të amendamenteve nga komisionet kryesore kemi vërejtje nga dy komisione: Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Sala Berisha Shala – Në fillim e përshëndeti plotësimin e stafit të njësisë mbështetëse të Komisionit me Muhamet Morinën, inxhinier. Sa i përket çështjes së vërejtjeve të paraqitura nga Komisioni për Legjislacion dhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa,

theksoi: Edhe pse nuk janë plotësisht të qarta, grupi i punës do të mbledhet dhe do t'i shqyrtojë.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Grupi i punës për Projektligjin për miniera dhe minerale nr. 03/L-163 të mbledhet dhe në mbledhjen e radhës ta propozojë Raportin për shqyrtim dhe për miratim.

c) Monitorimi i Ligjit të telekomunikacionit nr. 2002/7

Zef Morina – Raportoi se grupi i punës deri më tani ka realizuar takime të rregullta me MTPT-në dhe me ART-në, ndërsa brenda kësaj jave do të ketë takim edhe me PTK-në.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Grupi i punës për mbikëqyrjen e Ligjit për telekomunikacion nr 2002/7 të realizojë takim me PTK-në më 18. 06. 2010.

d) Projektligji për ndërmarrjet publike

Kryetarja – Njoftoi se kemi dritë të gjelbër nga Kryesia e Kuvendit që Komisioni ta hartojë Projektligjin për ndërmarrje publike.

e) Projektligji për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 03-L139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03-L205

Kryetarja - Kërkoj të formohet grup i punës që ta shqyrtojë këtë Projektligj.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 03-L139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03-L205, në këtë përbërje: Adem Grabovci (kryesues), Myzejene Selmani, Ethem Çeku, Mursel Halilji dhe Zef Morina.

f) Projektligji për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr. 03/L210

Kryetarja - Kërkoj të formohet grup i punës që ta shqyrtojë këtë Projektligj.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Formohet grupi i punës për Projektligjin për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr. 03/L210, në këtë përbërje: Sala Berisha Shala (kryesuese), Ethem Çeku dhe Murselj Halilji.

g) Pakoja e projektligjeve të energjisë

Kryetarja - Kërkoj të shtohet puna dhe të hartohen amendamentet e Pakos së projektligjeve të energjisë.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Grupi i punës për Pakon e projektligjeve të energjisë e ka këtë përbërje: Sala Berisha Shala (kryesuese), Myzejene Selmani, Ethem Çeku dhe Zef Morina.

h) Mbledhja e radhës

Ethem Çeku – Kërkoj që në mbledhjen e radhës të ftohet Bordi ose personat kompetentë të Bankës Qendrore të Kosovës – BQK, që të diskutohet për politikën zhvillimore të sistemit bankar në Kosovë dhe për aplikimin e Ligjit të konkurrencës.

Kryetarja – E paraqiti shqetësimin se mos këtë çështje do duhej ta shqyrtonte Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Fatmir Rexhepi – Çdo çështjeje, që e ka për bazë ekonominë, i takon të shqyrtohet nga Komisioni ynë. Propozoj që së pari Komisioni të marrë njoftime për të gjitha çështjet që rregullohen në këtë fushë, d.m.th. të sillet material shtesë dhe pastaj mund të ftohen përfaqësuesit e institucionit në fjalë për të raportuar ose për ta njoftuar Komisionin për këtë çështje.

Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit – BQK-ja mund ta njoftonte Komisionin edhe për çështjen e OJQ-ve, që fushëveprim të tyre i kanë mikrofinancat. Po ashtu propozoi të ftohet edhe Komisioni i Konkurrencës, i cili do të japë njoftime më të hollësishme për çështje të tjera të monopolit financiar.

Zef Morina – Propozoi që së pari të sillet materiali shtesë, pastaj të ftohet BQK-ja në Komision.

Sala Berisha Shala – Kërkoj që në një mbledhje të radhës të diskutohet çështja e Trepçës, sepse është temë mjaft e ndjeshme dhe kërkon trajtim përkatës të Komisionit.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Përfundim

- I. *Në mbledhjen e radhës rendi i ditës ta ketë këtë përmbajtje: 1. Rishqyrtimi i Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163 dhe 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr. 03/L-210.*
- II. *Të kërkohet material relevant nga BQK-ja për politikën e sistemit bankar dhe për ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik të vendit në afat 7-ditor. Pastaj të ftohet Bordi Drejtues në mbledhjen e Komisionit më 22. 06. 2010.*
- III. *Çështja e Trepçës të trajtohet në një mbledhje të rregullt të Komisionit brenda sesionit pranveror.*

Mbledhja përfundoi në orën 13: 00

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani